

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHER
Nr. 266 Date 24. 05.2001


Per
Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Sh.A "UJESJELESI" KAVAJE

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926 , date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare" ndryshuar me Dekretin Nr.1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996 dhe nenit 164 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem

URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.A "UJESJELLESI" Kavaje te behen ndryshimet e meposhtme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren e pasuruse se sektorit te kanalizimeve prej 26 579 000 leke e barabarte me 26 579 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A "UJESJELLESI" Kavaje te behet nga 626 815 000 leke ne 653 394 000 leke e barabarte me 653 394 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike dhe Drejtoria e Shoqerise te bejne veprimet perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare.



RAPORT

EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Për përgatitjen e dokumentacionit për zmadhimin e Kapitalit Themeltar.

Parashikuar nga neni 150 i ligjit 7638
dt 19.11.1992 "Për Shoqerite Tregtare".

Sh.A „UJSJELLES!“

Selia KAVAJE

Tel 05742821

05742717

Kapitali Themeltar 626815000 lekë.

MARIE DUSHI

E.K.A

I.4 Rr »Skenderbej «nr 453

DURRES

Tel 05226716, portabel 0382192983

Aksioner!

Me vendimin e Gjykes se Rrethit Tirane nr _____ dt _____ i marë në bazë te Urdhërit të M.E.P.P nr 556 datë 16.10.2000 ,kam qene e ngarkuar si eksperte kontabël për përgatitjen e raportit për zmadhimin e Kapitalit Themeltar të shoqërisë tuaj,për vlerën e pasurisë së sektorit të Kanalizimeve..

Un kam nderin t'ju raportoju Juve për ekzekutimin e këtij misioni,i cili konsiston në :

a-Kontrollin e dokumentacionit të përgatitur nga shoqëria,për vlerën e pasurisë së sektorit të kanalizimeve që do të përfshihet në kapitalin Themeltar,kundrejt emetimit të aksioneve të reja në përfitim të shtetit si aksioner i vetëm i Sh.A „UJSJELLES!“ Kavajë..

b-Përgatitja e raportit përkatës për zmadhimin e kapitalit .

Për përmbushjen e misionit ,un kam disponuar:

1*Urdhërin e M.E.P.P nr 556 datë 16.10.2000.

2*Bilancin e Transformuar,mbas përfshirjes së aktivitetit të sjellë nga Kanalizimet.

3*Inventarin fizik të pasurisë së transferuar nga Ndërmarrja Komunale(sektori i Kanalizimeve),gjëndje në magazinë datë 31.12.2000.

4*Dokumentacionin përkatës për hyrjen e pasurisë në aktive të shoqërisë dhe kontabilizimin e tyre.

Pasi bëra të gjitha verifikimet përkatëse në referencë me rekomandimet dhe normat e profesionit, si dhe kërkesave ligjore

Konstatova se:

Me Urdhër të Ministrisë Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr 556 datë 16.10.2000 ,si zotëruese e vetme e aksioneve shtetërore të sh.a "Ujsjellësi"Kavajë,është vendosur që të zmadhohet kapitali Themeltar i shoqërisë në fjalë, me vlerën e pasurisë ,sjellë nga kanalizimet Kavajë,aktualisht ndërmarrje shtetërore.



Vlera e pasurisë gjithsej, që do përfshihet në kapitalin Themeltar ,e saktësuar me inventare fizike dhe komisioni i vlerësimit, pranë shoqërisë, është **26579000** lekë ,e barabartë me **26579** aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion (përcaktuar në aktin e themelimit të shoqërisë,statut dhe vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr 24149 datë 11.07.2000).

Aktivi i përfshirë në kapitalin Themeltar të shoqërisë ka këtë strukturë:

Nr	Aktivi	Vlera për kapitalizim	Vlera në hyrje	Dokumentimi
1	Kanalizime	20734000	20734074	Akt Marje ne Dorezim dt 26.12.2000 Hyrje
2	Mjete Transporti	2900000	2900000	date 26.05.2000
3	Makineri	1750000	1750000	Hyrje datë 26.05.2000
4	Materiale	1021000	1021380	Hyrje datë 26.05.2000
5	Inventar i imët	174000	173491	Hyrje datë 26.05.2000
	TOTALI	26579000	26578945	Hyrje datë 26.05.2000

Un kam verifikuar egzistencën,pronësinë ,vlerësimin e dokumentimin dhe konkludova se aktivet me vlerë **26579000** lekë:

Egzistojnë,e vërtetuar kjo me inventarin fizik të datës 31.12.2000 ,bashkengjitur raportit.

Janë vlerësuar drejt. Kanalizimet me vlerën kontabël të mbetur e saktësuar me indeksin e vlerësimit të pasurisë. Aktivet e tjera (mjete trasporti,makineri e gjëndje inventari),janë vlerësuar me vlerën e sjelljes apo të dhurimit. Nga verifikimet e mundëshme që bëra konstatova se vlera e dhënë i përgjigjet vlerës venale.

Pronësia shtetërore vërtetohet me titullin nominal të dokumentave të sjelljes, të pranuarra ,bërë hyrje dhe kontabilizuar në pasurinë e shoqërisë

Aksionet e emetuara kundrejt këtij kontributi janë **26579** me vlerë nominale 1000 lekë/aksion.

Kapitali Themeltar rritet për **26579000** lekë.

Si rezultat nga **626815000** lekë,kapitali bëhet **653394000** lekë,i ndarë në **653394** aksione me vlerë nominale **1000** lekë/aksion.

Durrës më 17.Maj .2001



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RBETHIT TIRANE
Nr. 24/99/1 Akt.

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 19.12.2001 une, gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Mustafa Cefo, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zv/ Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z. Pajtim BELLO lidhur me depozitimin ne regjistrin tregtar te urdhrin Nr. 266 , date 24.05.2001 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z. Mustafa MUÇI dhe

Konstatova:

Se me vendimin Nr. 4479 date 07.06.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane, Shoqeria Anonime "Ujesjelles" Kavaje eshte regjistruar si person juridik.

Me urdhrin Nr.266 , date 24.05.2001 eshte vendosur zmadhimi I kapitalit te shoqerise per vlere e pasurise se sektorit te kanalizimeve prej 26 579 000 leke dhe kapitali themeltar behet 626 815 000 leke e barabarte me 653 394 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Nga shqyrtimi I akteve te paraqitura nga kerkuesi rezulton se ato jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

Per kete arsye:

Ne baze te nenit 24 te Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993

VENDOSA:

Depozitimin e Urdhrit Nr.266 , date 24.05.2001 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me ndryshimin ne aktin e themelimit te Sh.A. "Ujesjelles" Kavaje, duke bere shenimin ne fleten e regjistrin ne kollonen 4 dhe 5 me Nr rendor 2.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri.

Te publikohet vendimi I mesiperm.

GJYQTARE

Mustafa Cefo
